

PROCESVERBAL
“I HEDHJES SË SHORTIT MANUAL”

I mbajtur sot me datë 05.04.2019 ora 12.03, nga sekretare Rediona Myrtja, në prani të:

- | | |
|--------------------------|-----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 6. Fatjona Memcaj | (anëtar) |
| 7. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësues) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

Erinda Ballanca, Avokati i Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

Mimoza Arbri, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaroi fillimin e procedurës për hedhjen e shortit dhe përcaktimin e anëtarëve relatorë për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani parashtron se sikurse vendosem në seancën e parë të mbledhjes, do të procedojmë në këtë mënyrë. Do të vendosim emrat e anëtarëve në një vazo. Pastaj vendosen, në një fazë të parë, 7 pozicionet vakante në vazon tjetër. Do të kryejmë shortin dhe me përfundimin e tij do të vijojmë me një fazë të dytë. Përsëri do të vendosen 7 emrat e

anëtarëve dhe në vazën tjetër dy pozicionet vakante plotësuese me afat deri në muajin maj 2019.

Sikurse e parashikon vendimi normativ i KED nr.2/2019, në pikën 29, shorti manual organizohet me dy kuti transparente. Në njëërën prej kutive vendosen goglat me emrat e secilit prej anëtareve të Këshillit dhe në kutinë tjetër vendosen goglat me secilin nga pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin. Numri total i goglave në secilën kuti duhet të përputhet përkatësisht me numrin e anëtareve të Këshillit dhe me numrin e pozicioneve vakante që shortohen.

Fillojmë me procedurën në fazën e parë të shortimit. Do të shortohen vendet vijuese:

1. Mandati i shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018,
2. Mandati i shpallur nga Kuvendi 12.02.2018,
3. Mandati plotësues i shpallur nga Presidenti me 07.02.2018,
4. Mandati i plotësues i shpallur nga Kuvendi 28.08.2018,
5. Mandati i shpallur nga Presidenti me 04.03.2019,
6. Mandati i shpallur nga Kuvendi në 4 Mars të 2019 dhe
7. Vendi vakant i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas pikës 30 të vendimit normativ nr. 2/2019, shorti zhvillohet në prani të pjesëmarrësve dhe punonjësve administrative të Gjykatës së Lartë. Pra do të veproni një e nga një, duke ia treguar pjesëmarrësve dhe lexuar me zë të lartë veprimet dhe duke vendosur në secilën gogël një shirit letre që përmban emrat e secilit prej anëtareve të Këshillit dhe të gjitha goglat, për të 7 anëtarët, do të vendosen në njëërën nga vazot. Punonjësit do të fillojnë veprimet, do ti lexoni emrin e anëtarit dhe e vendosni në vazo. Do ta bëjmë këtë veprim 7 herë.

Lexohen emrat e anëtareve nga punonjësi i Gjykatës:

1. Ardian Dvorani
2. Arta Marku
3. Fatri Islamaj
4. Fatjona Memcaj
5. Margarita Buhali
6. Vitore Tusha
7. Eriol Roshi

Lexohen vendet vakante nga punonjësi tjetër i Gjykatës:

- Vendi Vakant Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Presidenti datë 07.02.2018
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat i shpallur nga Presidenti datë 07.02.2018
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat i shpallur nga Kuvendi datë 12.02.2018
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi datë 28.08.2018
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Presidenti datë 26.11.2018
- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi datë 24.12.2018

Ardian Dvorani - Të lutem dhe njëherë të përsëritet procedura sepse u dha orientimi që në fazën e parë dy vendet vakante të fundit që u lexuan nuk duhen përfshirë. Të përsëriten veprimet.

Erinda Ballanca - Hapini edhe njëherë nga e para.

Hapen goglat edhe njëherë dhe nxirren shiritat në të cilën janë shënuar pozicionet vakante

Ardian Dvorani - Kryeni veprimet sikurse ua them unë dhe me ndiqni me veprimin përkatës :

1. Mandati i shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018,
2. Mandati i shpallur nga Kuvendi 12.02.2018,
3. Mandati plotësues i shpallur nga Presidenti me 07.02.2018,

Ardian Dvorani - E keni shkruaj fjalën plotësues në letër?

Punonjësi administrativ- jo

Ardian Dvorani- Ma jepni ta shkruajmë me dorë, për ta dalluar, sepse dy vakanca me të njëjtën datë.

Erinda Ballanca - Shkruajeni me dore aty.

Ardian Dvorani vijon me leximin e pozicioneve vakante:

4. Mandati i plotësues i shpallur nga Kuvendi 28.08.2018,
5. Mandati i shpallur nga Presidenti me 04 Mars2019,
6. Mandati i shpallur nga Kuvendi në 4 Mars të 2019 dhe
7. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani - Ato që mbeten janë?

Këshilltari Besmir Rrapaj – Mandat Plotësues nga Kuvendi shpallur në 24.12.2018 dhe ai plotësues i shpallur nga Presidenti datë 26.11.2018

Ardian Dvorani - Po mbajeni ato veç. Të, verifikohen në vazo që të jenë 7 gogla.

Numërohen 7 gogla nga punonjësi administrativ .

Ardian Dvorani –Tani ju udhëzoj unë. Mirë atëherë, sipas pikës 32 të vendimit të Këshillit do të fillohet me veprimin tërheqjen e goglës nga kutia transparente që përmban pozicionet vakante.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat i shpallur nga Kuvendi datë 12.02.2018.

Ardian Dvorani – Dhe tani nga kutia tjetër zgjidhni një gogël nga anëtarët.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ - Znj.Vitore Tusha

Ardian Dvorani- Për vendin vakant, mandat i shpallur nga Kuvendi datë 12.02.2018, relatore znj. Vitore Tusha. Procedoni me tërheqjen e një gogle për vendet vakante.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant, mandat i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ - Z. Fatri Islamaj

Ardian Dvorani -Vijoni me tërheqjen e e një gogle për vendet vakante.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Inspektori i Larte i Drejtësisë

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Znj.Margarita Buhali.

Ardian Dvorani –Mirë, vijojmë me një vend tjetër vakant.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat shpallur nga Kuvendi date 04.03.2019.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Znj.Fatjona Memçaj

Ardian Dvorani –Mirë, vazhdojmë me pozicionin tjetër vakant.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ-Vendi vakant Gjykata Kushtetuese mandat plotësues i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Eriol Roshi

Ardian Dvorani -Jemi në një tjetër vakancë.

Eriol Roshi –Kjo ishte plotësuese?

Ardian Dvorani –Eriol Roshi, për mandatin plotësues.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- z.Ardian Dvorani

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Znj.Arta Marku

Ardian Dvorani - Përfundimisht lexojmë rezultatin për 7 pozicionet e para :

Mandat i Shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018

Relator:Arta Marku

Mandat i Shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018

Relatore:Vitore Tusha

Mandat plotësues i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018

Relator:Eriol Roshi

Mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018

Relator: Ardian Dvorani

Mandat i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019

Relator:Fatri Islamaj

Mandat i Shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019

Relator:Fatjona Memçaj

Dhe për ILD: Margarita Buhali.

Mirë atëherë do të vendosni, lutem më ndiqmi mua mos ngatërroheni, vendosni emrat e anëtareve edhe njëherë te shtatë, lexojini,

Punonjësi administrativ lexon dhe vendos në gogla:

1. Arta Marku
2. Ardian Dvorani
3. Eriol Roshi
4. Fatjona Memçaj
5. Margarita Buhali
6. Fatri Islamaj
7. Vitore Tusha

Ardian Dvorani- Atëherë vendosni në vazon e vendeve vakante, mandatin plotësues shpallur nga Presidenti datë 26.11.2018. Me kujdes mos u nxitoni. Vendosni edhe mandatin plotësues të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018. Mirë atëherë procedojmë në të njëjtën mënyre. Përziejmë vazon e vendeve vakante nxirrni një gogël.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018

Ardian Dvorani – Mirë atëherë relatori

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- z. Ardian Dvorani

Ardian Dvorani - Mirë atëherë merrni vendin tjetër vakant.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Mandat plotësues i shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 26.11.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- znj. Vitore Tusha

Ardian Dvorani- Mire, atëherë faleminderit. Tani do vijojmë me procedurën për shortimin e këshilltarëve në të njëjtën mënyrë. Tani do më ndiqni me vëmendje sepse do ta bëjmë tre herë këtë procedure. Fillimisht do të vendosim mandatin ose pozicionin vakant të ILD edhe këtë e bëjmë, siç e sqaruam në mbledhje, për shpërndarjen ngarkesës. Vendose. Tani vendosni mandatin e shpallur nga Presidenti me date 07.02.2018. Vendosni mandatin e shpallur nga Kuvendi me datë 12.02.2018. Vendosni edhe mandatin e shpallur nga Presidenti 04.03.2019. do të lexoni edhe emrat e këshilltareve, janë katër këshilltare, do zgjedhim katër vendet vakante përkatëse dhe pastaj do procedojmë me vendet e tjera vakante.

Punonjësi administrativ Lexon emrat e këshilltareve dhe vendosen në gogla në vazò:

1. Laureta Nezaj.
2. Engert Pellumbi.
3. Sajmir Nazifi.
4. Besmir Rrapaj.

Ardian Dvorani – Mirë atëherë e njëjta procedure do filloni me vendin vakant

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant ILD.

Ardian Dvorani -Mirë atëherë nga emrat e këshilltareve?

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Laureta Nezaj

Ardian Dvorani- Tërhiqni një gogël nga vendet vakante.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat i shpallur nga Presidenti datë 04.03.2019.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Besmir Rrapaj.

Ardian Dvorani- Procedoni me vendin tjetër vakant.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ-Vendi vakant Gjykata Kushtetuese mandat i shpallur nga Presidenti 07.02.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Engert Pëllumbi

Ardian Dvorani- Dhe e fundit, vendi vakant Gjykata Kushtetuese mandat i shpallur nga Kuvendi date 12.02.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Saimir Nazifi

Ardian Dvorani –Mirë atëherë. Më dëgjoni me vëmendje që të mos ketë ngatërresa.

Vendosni në vazo:

- Vendi vakant i shpallur nga Kuvendi me datë 04.03.2019.
- Vendi vakant plotësues i shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.
- Vendi vakant plotësues i shpallur nga Kuvendi me datë 28.08.2018
- Vendi vakant i plotësues i shpallur nga Presidenti me datë 26.11.2018

Përpara se të vazhdojmë me tërheqjen goglave nga vendet vakante, fillojmë me emrat e këshilltarëve.

Lexohen emrat e këshilltarëve nga punonjësi administrativ

1. Engert Pellumbi
2. Besmir Rrapaj
3. Saimir Nazifi
4. Laureta Nezaj

Ardian Dvorani - Tërhiqni një pozicion vakant.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant plotësues Gjykata Kushtetuese, i shpallur nga kuvendi me datë 28.08.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Saimir Nazifi

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Engert Pellumbi

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, mandat plotësues i shpallur nga Presidenti me date 26.11.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Laureta Nezaj

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Vendi vakant Gjykata Kushtetuese, i shpallur nga Kuvendi me date 04.03.2019.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Besmir Rrapaj .

Ardian Dvorani – Mirë atëherë. Ka mbetur vetëm një pozicion vakant dhe do të vendosim emrat e këshilltareve në vazo.

Lexohen emrat e këshilltarëve nga punonjësi administrativ:

- Besmir Rrapaj
- Engert Pellumbi
- Saimir Nazifi
- Laureta Nezaj

Ardian Dvorani-Tërhiqni për vendin vakant

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ - Vendin vakant Gjykata Kushtetuese mandat plotësues i shpallur nga Kuvendi me 24.12.2018.

Tërhiqet gogla nga punonjësi administrativ- Engert Pëllumbi

Ardian Dvorani –Procedura e shortit, praktikisht ka përfunduar. Po e lexoj edhe njëherë rezultatin e shortit:

Për mandat shpallur nga Presidenti me datë 07 shkurt 2018 relatore Arta Marku, këshilltar Engert Pëllumbi

Për mandatin e shpallur nga Kuvendi me datë 12 Shkurt 2018 relatore Vitore Tusha, këshilltarë z. Sajmir Nazifi

Për vendin mandat plotësues i shpallur nga Presidenti i Republikës me date 07 shkurt 2018 relatore z Eriol Roshi, këshilltar Engert Pëllumbi

Për mandatin plotësues të shpallur nga Kuvendi me datë 28.08.2018 relator Ardian Dvorani, këshilltarë Saimir Nazifi

Për mandatin e shpallur nga Presidenti i Republikës me datë 04.03.2019 relatore z. Fatri Islamaj, këshilltare z Besmir Rrapaj

Për vendin vakant shpallur nga Kuvendi datë 04.03.2019 relatore Fatjona Memcaj, këshilltarë z Besmir Rrapaj

Për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, relatore znj. Margarita Buhali, këshilltare Laureta Nezaj

Dhe për dy vendet vakante të fundit :

Mandat plotësues i shpallur nga Presidenti i Republikës me datë 26.11.2018 relatore znj.Vitore Tusha dhe këshilltar znj. Laureta Nezaj

Mandati plotësues i shpallur nga Kuvendi 24.12.2018 relator Ardian Dvorani, këshilltar Engert Pëllumbi,

Ky është rezultati i shortit dhe sigurisht duhet ta bëjmë publik. Rezultati i shortit është pjesë komunikatës për median për ditën sotme. Është edhe detyrim ligjor përveçse për efekt të transparencës.

Procedura e shortit deklarohet e përfunduar.

MBYLLET PROCEDURA E SHORTIT

Sekretare

Kryetari

Dorina Dulaj

Ardian Dvorani

Ermelinda Kadiu

Redjona Myrtja